

INFORMATA MBI GRANTIN

Emri i grantit:	“Siguria e hapsirës së Termokiss”
Instrumenti:	Grant urgjent
Subjekti zbatues:	OJQ Rritu
Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):	Rr. Ilaz Kodra, PN, Prishtinë. termokiss@gmail.com +383 49 686 404 https://futureunderconstruction.hotglue.me/
Kohëzgjatja e grantit:	Data e fillimit: 15/07/2025 Data e përfundimit: 15/09/2025
Buxheti total i grantit (EUR):	3.000 EUR
Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):	3,000 EUR
Grupet e synuara:	• Komuniteti i pergjithshëm i Termokiss • Komuniteti LGBTQ+ • Gratë • Rinia • Pakicat etnike
Shtrirja gjeografike:	Prishtinë, Kosovë
Përmbledhje e grantit:	Qendra kulturore Termokiss, e vendosur në Prishtinë, ka shërbyer për nëntë vite si një hapësirë gjithëpërfshirëse për komunitetin, duke ofruar mbi 1000 aktivitete kulturore dhe sociale falas, të organizuara dhe udhëhequra nga vetë komuniteti. Termokiss ka qenë një hapësirë e sigurt për grupe të marginalizuara si komuniteti LGBTQ+, gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë,

Bashkëfinancuar nga:



	duke promovuar demokracinë direkte dhe përfshirjen aktive të qytetarëve në jetën kulturore dhe publike të qytetit. Aktualisht, hapësira po përballët me kërcënime serioze pas një serie sulmesh sistematike që kanë ndikuar drejtpërdrejt në vazhdimësinë e funksionimit të iniciativës. Përballë mungesës së reagimit institucional, komuniteti ka ndërmarrë hapa konkretë për të siguruar mbrojtjen dhe funksionimin e mëtejshëm të Termokiss. Ky projekt synon të ndërhyjë urgjentisht për të rikthyer ndjenjën e sigurisë në hapësirë dhe për të garantuar vazhdimësinë e aktiviteteve kulturore e sociale. Objektivat përfshijnë instalimin e dyerve të garazhës mbi dyert e xhamit të cilat në vazhdimësi po sulmohen. Aktivitetet do të realizohen përmes vlerësimeve teknike dhe bashkëpunimit me kompani të specializuara. Ndërhyrja do të zhvillohet në objektin e Termokiss, në lagjen Dardania të Prishtinës. Përtej masave fizike të sigurisë, intervenimi paraqet një akt solidariteti dhe rezistence qytetare kundër frikës dhe dhunës, duke krijuar kapacitete përreagime të mëtutjeshme për mbrojtjen e hapësirave të ngjashme alternative në qytet dhe më gjerë.
--	--